



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATË/A	07.03.2018
REFERENC-Ë :	
PËR/ZA/TO:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunes se Lipjanit
CC:	Fauz Xheaili - Nënkyetar i Komunës Lipjan
	Lulzim Qerimi - Nënkyetar i Komunës Lipjan
NGA/OD/FROM:	Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raport Mujor 01.03.2018 - 31.03.2018

Projekti "Tregu i gjelbër" është përzgjedhur për të u bashkëfinacuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. Konfirmimin e kemi pranuar më 29.03.2018. Komuna e Lipjanit ka aplikuar me këtë projekt në thirrjen e hapur nga Ministria në Programin për Zhvillim Rajonal 2018 më 09.02.2018. Ministria e Zhvillimit Rajonal do ta bashkëfinancoj këtë projekt në vlerën prej 70,000.00 €; ndërsa, Komuna e Lipjanit do të bashkëfinancoj në vlerën prej 68,725.51 €.

Thirrja për Aplikim nga Organizata Help "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor 2017-2018" është mbyllur më 09.03.2018. Në këtë thirrje kanë aplikuar gjithsej 228 aplikant. Organizata Help ka filluar regjistrimin dhe fazën e parë të përzgjedhjes së aplikantëve. Nga kjo thirrje do të përfitojnë se paku 38 aplikues.

Thirrja nga Projekti ReLOaD për mbështetje të OSHC-ve është mbyllur më 14.03.2018. Komisioni vlerësues i formuar nga Kryetari i Komunës është në proces të vlerësimit të aplikacioneve. Trajnimi i komisionit për vlerësimin e aplikacioneve është bërë nga UNDP, projekti ReLOaD, dhe komisioni është në bashkëpunim me UNDP rreth caktimit të datës për vlerësim të aplikacioneve.

Më 29.03.2018, në Asablenë Komonale kemi paraqitur propozimin e Kryetarit të Komunes mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat Komonale 15Nr.011-17139 të datës 05.04.2016.

Më 08.03.2018, në sallën e Kuvendit Komunal se bashku me ASB-PREDA jemi takuar me shoqatat e fermerëve të Komunës së Lipjanit. Qëllimi i takimit ka qenë informimi i shoqatave rreth thirrjes së ASB-PREDA dhe mundësisë së përkrahjes financiare për shoqatat nga kjo organizate.

Më 15.03.2018, jemi takuar me Organizatën PEN (Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatar) dhe kemi diskutuar rreth mundësisë së përzgjedhjes së Komunës së Lipjanit nga PEN për projektin "Social Act". Qëllimi i këtij projekti është krijimi i bashkëpunimit në mes të Komunës dhe PEN në promovimin e gjithëpërfshirjes sociale, fuqizimin e të rinjëve të moshës 18-25, formimin e rrjeteve

profesionale me të rinj dhe mbështetjen e të rinjëve në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave në komunitet.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të të bërit Biznes, Komuna e Lipjanit ka filluar përgatitjet me IFC/ Bankën Botërore për fillimin e projektit “Përmirësimi i Klimës së Investimeve II përmes thjeshtëzimit të procedurave administrative”. Ky projekt ka për qëllim që të evidentoj të gjitha lejet, licensat, pëlqimet dhe procedurat administrative në një regjistër elektronik dhe pastaj të zbatoj thjeshtëzimin e gjithanshëm rregullator të këtyre licencave, lejeve, miratimeve, certifikatave dhe dokumenteve tjera relevante. Kjo do të ndikoj në zvoglimin e mëtutjeshëm të kostos dhe kohës së sektorit privat përmes rritjes së efektivitetit dhe përmirësimit të shërbimeve administrative komunale. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ka dërguar propozimin për aprovim të grupit punues për këtë projekt.

Komuna e Lipjanit është renditur në mesin e Komunave me performancë të mirë nga Raporti i Performancës për vitin 2016, i vlerësuar nga DEMOS dhe MAPL. Si rezultat Komuna e Lipjanit ka përfituar Grantin e Performancës në vlerë prej 103,011.00€.

Në Sektorin Pronësores-Juridik kemi dorëzuar raportin e rregullt mujor për pagesën e qerave, sipas kontratave të lidhura për lokalet dhe pronat tjera komunale.